

E

BIBLIOTEKA

SHIFRI

85H-1

M 98

GJIROKASTER

BESNIK  
MUSTAFAJ




Pragu  
i verës

POEZI

81H-1  
M 98

**Besnik  
Mustafaj**



33143

**Pragu  
i verës**

**poezi**

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## JETA E UDHËVE

*shokëve të mi gazetarë*

Ec!

Mbi sytë e tu, në zemrën tënde  
udha shkruan jetën e vet.

Udha s'është udhë pa udhëtarë.  
Shoferi i kamionit që të gjeti në shi,  
qortimi miqësor i një minatori  
duke pirë kafe me të  
se nuk zbritë ta takosh atje poshtë,  
një vajzë fshati që të sheh në sy  
pa u skuqur më, të sjell ujë nga shtëpia  
të pastrosh baltën e fushës në këpucë,

një dorë veterani mbështetur në sup,  
këmbëngulja e sinqertë t'i shkosh për drekë,  
një fëmijë i panjohur që të pyet për orën  
e rënd në shkollë të kap mësimin;  
përherë, përherë  
në udhët tona nuk ngelesh vetëm.

Në mëngjes e në mbrëmje, ditën e natën  
ec!

Zgjerohen sytë, zgjerohet zemra.

Pambarimisht udha kërkon vend

për të shkruar aty jetën e vet.

Shkruar nga ...

1981

Shkruar nga ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

... në ...

## TRI KËNGË PËR NËNËN

### 1. Nëna

Nëna, e heshtura,  
në rrembat e gjakut tonë, në zemër.

Në rrugët ku hyjmë, të mëdha e të vogla,  
kudo shkojmë, kudo ecim,  
para se të vëmë këmbën ne  
në tokë mbështetet këmba e nënës  
e provon fortësinë e saj.

Aty ku mund të shfaqen sirenat  
na zë veshët,  
aty ku duhet të këndojmë, të qeshim,  
bëhet dritë në buzët tona, në sy.

Ulisi kujtonte se ish Athinaja,  
e s'e dinte se ajo ish nëna.

## 2. Përsëri për nënën

Dikush i tha nënës se kishte djalë të mirë,  
nëna ime vetëm qeshi pak:

Kur erdhi në shtëpi, në darkë,  
puthi fotografinë time,  
në tryezë shtroi një pjatë më shumë.

Dhe u ul aty ku ulesha unë...

## 3. Letër nënës

E dashur nënë!

U bënë muaj pa të parë.

Një punë e re që del papritur

MAT

ma shtyn më larg ardhjen për ditë.

Ti asnjëherë, asnjëherë

të lyp të falur s'më kërkon,

veç ndiej nga larg si psherëtin

kur më thua se je mirë.

Me zërin tim ende në vesh

mendon me vete për një çast:

«Ky biri im... mirë, mirë,

u bëftë punëtor!

Le të mësojë se dita e tij

edhe për mua gjithnjë ka kohë».

Kaq mund të thuash, ti je nënë,

s'do kurrsesi që djalit tënd

ti flasin ashpër, ta qortojnë

se paska lënë një punë pa bërë

të vijë thjesht sa të të shohë.

Kaq mund të thuash, ti je nënë.

## TANI

Tani nuk rritem më. Eshtrat janë lidhur me  
njëra-tjetrën,  
secila në vendin e vet. Numri i këpucëve  
s'ndryshon më.  
Ushqehem me rrogën time. Kam gruan sa vetja  
dhe pres fëmijë.  
Të tjerët s'thonë më: «I biri i filanit». Kam  
emrin tim.

I kam të gjitha këto gjëra të thjeshta, të  
përditshme  
brenda në trupin tim si jetë e jashtë si stoli.  
Thellë shpirtit kanë nisur të më zgjohën  
vulkanet  
nga oshëtimat e gjakut në deje prej thirrjes së  
jetës.



## HERONJTË

Unë isha i vogël e heronjtë shumë të mëdhenj,  
shumë më të lartë se trupat e statujave të

Duke u rritur, gjithnjë e më pak i shihja nga  
sa erdhi moshë kur u pamë sy më sy.  
poshtë

Tani unë kisha hyrë brenda tyre thellë  
dhe kisha zbuluar tek ata njerëzit e thjeshtë  
që me dashurinë e natyrshme për gruan, fëmijët,  
e ngrohnin edhe pragun e shtëpive.  
tokën

Dhe kjo dashuri i bëri heronj.

## DONIKA

Flasim për Gjergjin,

për ditët e netët e gjata të rrethimeve,  
për luftërat e rrepta, fitoret,  
për kalin e tij të zgjuar dhe për shpatën e  
për shpesh të harrojmë ty.

Harrojmë si kthehej ai i lodhur nga betejat  
dhe te derë e prisje ti.  
I merrje në trupin tënd dhimbjet e plagëve të  
të fushave të djegur me grurë,  
të puseve të shterrura pa ujë  
për të mos ia lënë atij.

Se ai duhej të pushonte pak  
për të qenë përsëri nesër për luftë.

Koka e tij që s'përkulej përpara  
gjyleve të rënda të topave  
rrëzohej mbi supin tënd të butë.

Shihje si i rëndoheshin ngadalë qerpikët  
si i mbylleshin sytë.  
E, për t'ia bërë edhe ëndrrat më të lehta  
hyje vetë aty.

Ndaj kur ti i ishe e domosdoshme  
në rrethimet e gjata,  
aq e domosdoshme i je dhe tani në pavdekësi.  
Ndryshe si mund të themi se kemi njohur  
Gjergjin e vërtetë  
pa pjesën e vet që ka lënë tek ti!

## **VAJZAT KTHEHEN NGA FUSHA**

Vajzat kthehen nga fusha.  
Ato këndojnë e qeshin,  
ngacmojnë njëra-tjetrën  
të skuqura pakëz.

Prindërit e ndiejnë:  
pak hapa më tutje  
janë djemtë...

## VETËM UNË DO MBES E BARDHË

*motiv popullor*

Dardha veshur me të bardha,  
me të bardha veshur ti,  
lart një diell krijt i bardhë,  
luleshqerrat bardh nën këmbë.

Bardh... ç'më humbe midis tyre!  
Si të të gjej? Si tëotë gjej?

Mos u lodh, oti miri, prit:  
Lulet një nga një do cambyllen,  
dielli lart do perëndojë,  
vetëm unë do mbes e bardhë.

Diell e lule i kam në shtrat,  
Rend  
se do vijë mëngjesi prapë...

ENJOVAT E DEÇM QË SHKURIMAT

si Murqia e tjerë

SKENË NJËRËZORE  
*në autobusin urban*

Ora kur mbaron puna  
i derdh njerëzit në stacionet e autobusëve.

Të gjithë ata që presin, mënjanohen pak  
të hipë gruaja ime e parë.

Dhe sapo është brenda  
njëherësh i lëshohen shumë vende.

Së shpejti ajo do të bëhet nënë...

## NË QYTETIN E FËMIJËRISË

Tani këtu vij vetëm për të marrë diçka të lënë  
dikur,  
atë që atëherë ti ma jepje aq bujarisht  
po unë s'mund ta mbaja,  
syri im ish i vogël, shpirti im s'e zinte dot  
ndaj aty ka mbetur vetëm tingulli i saj, ngjyra;  
isha fëmijë e ato më rritën,  
më lidhën me botën e madhe.

Tani vij këtu për të marrë këtë pasuri,  
trashëgimia time prej gurësh, dheu, bore,  
drurësh,  
frymëmarrja e gjerë e lumit dhe e maleve,  
gjithnjë të paluajtshme,  
për të më mbajtur lidhur pas vetes,  
gjithnjë aty për të mos më lënë të vdes.

## BJESHKËT NË DIMËR

(pejzazh)

Tokë e pjerrët,  
shkëmbinj që nisin tek fytyrat e njerëzve  
e bien thikë mbi lumenj.

Mbi ta pak diell,  
si i mbajtur nga një dorë fëmije,  
lëkundet lehtë.

Dhe heshtje. Heshtje.

Trupi i brishtë i barit nën borë,  
lumenjtë e fryrë  
dhe shkrepitima nevrike e një rrufeje —  
brenda kësaj heshtjeje.

Tokë e pjerrët  
që mbahet te krahët e fortë të njerëzve  
për të mos u gremisur në humnerat e veta.



NE EKSPOZITËN E PIKTORËVE TE VEJËL

PËR VAJZAT

Edhe tek trajtat e buta të fytyrës së vajzave  
t'i kërkojmë malet  
siç i kërkojmë tek sytë e tyre lumenjtë.

Dhe do të kuptojmë se thellësitë e kaltra  
të dashurisë  
kanë shtrat shkëmbi...

33143



## NË EKSPOZITËN E PIKTORËVE TË VEGJËL -

E kuqja, e zeza e ja flamuri.  
E kaltra për qiellin e kaltër, të lirë.  
S'është pasiguria e dorës  
po krahët e shqipes dridhen nga padurimi  
i fluturimit.

Ushtari romak, pashai dhe nazisti  
s'mund ta kenë fytyrën veçse të zezë!  
Të zi vështrimin, gjakun dhe varrin.  
Po rrufetë në sytë e partizanit që i mban në  
grykë të pushkës  
janë të kuqe.

Në dritën e atyre rrufeve  
toka rrit me ngut grurin.

## MINIATORI MALFOSË

Fëmijët rëndin të mbledhin kallinjë.  
Në një balonë tabake kanë zbritur aty  
vetë diellin.

Babai kthehet i lodhur nga puna.  
Si baba ngjan me heronjtë e filmave, të librave;  
pak me Skënderbeun, pak me Vojo Kushin,  
pak me Adem Rekën që sapo ka mundur detin.

Ndryshe si mund të jetë baba?!...  
Kohët s'kanë kufij të prerë midis tyre.  
Ato janë shtrat i njëra-tjetrës  
dhe shfaqin te njëra-tjetra të përjetshmen—  
jetën e Shqipërisë.

## MINATORËT MALËSORË

Ata vijnë nga fshati.

Takimi me nëntokën u zgjon fëmijërinë  
me ëndrrat për të fluturuar lart, lart,  
t'i mbajnë yjet në duar si kokrrat e misrit,  
t'u tregojnë gjyshërve se s'ka perëndi.

Këtu do të kenë vetëm një qiell të ulët guri,  
një qiell të vrazhdë pa stinë,  
pa diell as hënë, pa shirë, pa re.  
Në vend të bubullimave, të rrufeve  
do të ndëzin minat.

E tokës do t'ia mësojnë më mirë historinë  
duke i treguar ç'i kërkonin armiqtë.

## SHOKU

Pranë tavolinës sime, tavolina jote  
me librat e tua, fletoret  
dhe karrigia.

Gjithçka më bëhet e largët,  
e ftohtë  
aq sa shpesh s'guxoj të kthej kokën  
kur ajo është e zbrazët,  
kur ti aty mungon.

U dashkan edhe këto gjëra kaq të thjeshta  
për të të bërë të mendosh  
ç'është shoku.

Shoku që të afroka më shumë  
me tërë botën.

## SHËTITJE NATËN NË PYLL

Drurët, gurët, bari, lulet heshtin.  
Dhe unë, udhëtari i vonuar  
këndoј për të mos i lënë të treten në heshtjen  
e natës.

Në heshtjen e natës jam vetëm  
Këndoј dhe nata s'është më natë,  
unë s'jam më vetëm.  
Ndiej hapin e të dashurës që afrohet,  
dhe rrahjen e krahëve të zogjve,  
pemët tundin degët për të më thënë se janë  
pranë,  
në këmishën time të kaltër  
gjinkallat zgjojnë verën me diell,  
shoh sytë e të dashurës si mbyllen  
për të më mbajtur aty një çast,  
bëhem ajër, ujë, dritë, zjarr në buzët e saj.

Pylli që s'mund të heshtë më,  
për të mos ma prishur këngën  
ndalet diku larg...

## DËSHIRË PËR TË THËNË DIÇKA PËR ONUFRIN

Ti s'e kishe të lehtë të vije deri tek ne.  
Për këtë t'u desh ta bëje penelin tënd  
shpatë,  
ndryshe s'kishe ku ta gjeje atë të kuqë  
veçse tek gjaku.

Gjaku që i pikonte atdheut nga plagët.  
Dhimbjet e tij thernin në trupin tënd.  
Ndaj s'mund të rrije i qetë  
nën atë qiell çallmë.

Ti e dije se ato plagë mund të mbylleshin  
vetëm me zjarr  
dhe bëre jetën tënde flakë.

Vetëm kështu, nën dritën e tyre  
ti erdhe deri tek ne i gjallë.

I gjallë.

## VDEKJA E GJYSHIT

1.

Jemi mbledhur tërë të dashurit e tu:  
gjysha, dita e blertë e prillit, babai, nëna,  
era e ngrohtë që sjell shi për grurin,  
nusja ime, vëllezërit dhe unë.  
Ka ardhur halla me fëmijët,  
kanë ardhur sythat e hardhisë  
e tërë shokët e tjerë e miqtë.

Ne, të dashurit e tu,  
jemi mbledhur të gjithë  
Na ke përreth e prapë nuk ngre një dorë,  
s'lëviz një qepallë.  
Sigurisht, diçka e fortë të mban.  
Ne e ndiejmë, e shohim,

2.

Gjysh, o gjysh, çohu,  
ma bëre babanë të qajë!  
Çohu se do të të mbaj inat!



Çohu se s'të flas me gojë,  
as do të qaj të më pajtosh ti.  
Në darkë do të shkoj të fle shpejt,  
të pyesësh ti gjithë merak:  
«Mos është gjë djali sëmurë?»

Babai thotë se ke vdekur  
dhe të tjerët kështu thonë.  
Po jo, o gjysh, si vdes gjyshi?!  
Vdekja është e zezë e ti krejt i bardhë.

Çohu gjysh, mos bëj kështu,  
babai s'e di lojën tonë.  
Hape veç syrin pak  
të të shohësh ai e të mos qajë...

Çohu se po të lutem unë,  
ti je gjysh e s'e di ç'është babai,  
po babai me lot në sy  
më bën edhe mua të qaj.

Çohu pra, çohu për mua!...

3.

Në jetën e tij të gjatë bëri aq shumë  
sa edhe unë, nipi i tij,  
ta kuptoja gjuhën e gurit të bjeshkës,  
të më dhëmbë reja që shprishet në qiell  
pa lëshuar shi,  
të më dhëmbë hapi i nxituar i ndonjërit  
që kalon pranë pyllit, barit e dhenve  
e s'ndalon me ta një çast.

Kur e kuptoi se isha si ai  
gjyshi im vdiq fare i qetë



## SEPSE E DUA BOTËN

Kudo shkoj dua të lë diçka nga vetja,  
ta ndiej vendi ardhjen time e të gëzohet,  
të më drithërohet toka nën këmbë  
siç drithërohet trupi i bukur

nga prekja e pritur,  
të jetë vështrimi im për sendet që sheh  
edhe përkëdhelje, edhe qortim i dashur.

Sepse e dua botën,  
kam duart dhe mendjen për të.  
Për ta bërë më të gjallë,  
për ta bërë më të mirë,  
pak nga pak nëpër rrugët ku shkel i lë.

Kështu bota bëhet më e imja,  
përditë më fal jetë të panjohur më parë,  
me fytyra të reja, ku burojnë dashuri të mëdha,  
përmes zjarrit të tyre, unë, i palodhuri,  
e rikrijoj atë më të bukur çdo cast.

Me flijimin tim njerëzor, të heshtur,  
dita-ditës bëhem më zot i saj.

Duke e shndërruar gurin në statujë,  
lulen në frut, ujin në dritë,  
një nga një më zbardhen flokët  
nga të qëndruarit gjithnjë në diell...

## VAJTIM PËR EMIN DURAKUN

O Emin Duraku morë, oho!  
Të mori plumbi pas shpine, oho!  
S'ish plumb po dhëmb qeni, oho!  
S'ish qen po e kafshuar tradhëtie, oho!  
Oho, Emin Duraku morë!

Toka t'u hap nën këmbë  
të merrte në gji trupin tënd!  
Të lëvizën malet në sy,  
malet u sulën të të merrnin ty;  
dhe i vdekur si i gjallë ishe i tyre,  
O Emin Duraku morë!

Oho, Emin Duraku moré,  
lumë gjaku që rrjedh nëpër ditë!

Tokës iu bëre tokë e mirë  
të rrisë me dashurinë! tëndë bijtë,  
malit iu bëre mal i lartë  
të mbledhë aty stuhitë,  
stuhitë me rrufe për lirinë!  
Oho, Emin Duraku ynë!

## **JA, KOKA IME MBËSHTETUR TE TI...**

Ja, koka ime mbështetur te ti  
dhe jotja te unë.  
Përreth në mijëra forma  
rron dita jonë e kthyer në punë.

Prej saj si prej ëndrrës së bukur  
kemi dalë ne dhe mbrëmja.



## E DIELA E NJERËZVE TË PUNËS

PIONIERET DËSHMORE

E diela me një stol të bukur  
rri në skaj të gjashtë ditëve të tjera të punës;  
pret me durimin e të dashuruarit,  
të mbushet me zërat e njerëzve.

Kur ndodh t'u kalojnë fare pranë  
e të mos ulen,  
qoftë edhe për të marrë një frymë  
e për të fshirë pak djersët,  
ajo nuk fyhet  
veç i përcjell me një vështrim të dhembshur  
e i ndjek pas si një grua e mirë  
duke kërkuar nëpër ditët e tjera një çast.

Sepse e di se ata kanë nevojë për të  
sig kanë nevojë për të hënën e të shtunën,  
dhe kjo i mjafton për t'u shkrirë me dëshirë  
për t'ua ruajtur gazin në fytyrë,  
për t'ua bërë më të lehtë rrugën.

## PIONIERËT DËSHMORE

Ju ishit ende të parritur  
por patët kohë t'i ëndërronit të gjitha:  
bukën e ngrohtë, shtëpinë e bukur,  
rrobat e reja  
e librat  
për vete, për vëllezërit, motrat, për shokët.

Edhe për fëmijërinë e mbetur larg,  
në kohën tjetër,  
ëndërruat lodrat.

Kohë e luftës ish e shkurtër,  
ecte shpejt,  
po ju s'donit ta linit ëndrrën në mes,  
për këtë i mblodhët në moshën tuaj të parritur  
të tëra ditët e ardhme.

E rendët...

## DRITA E SYRIT

*Hapi sytë e zezë moj,  
të na sjellësh beharë.*

*popullore*

Si ë ndjekan edhe sendet dritën e syrit,  
lulëzokan dhe në pikë të dimrit.

E jo vetëm lulet, jo vetëm pemët,  
lulëzokan dhe gurët, lulëzokan dhe drurët  
kur shohin si zbutet era përpara

atij syri,  
si shndërrohen o fluturzat e boret

në petale të bardha  
për të lidhur fruta, për të mbledhur bletët.

Trishtimet e lehta të shiut të heshtur

TRISTIME E ARIET

... ..  
... ..

nuk janë më trishtime. Po as ~~thjeshtë~~ gëzime.  
Tani unë s'kam më kohë të merrem me veten  
... .. time.  
... ..  
Një sy është vogël për të mrokur botën  
... .. madhe.  
... .. Edhe dy  
janë ende pak. Përmbi cipën e hollë të ditës  
drita e syrit tënd lëviz e shumëzuar,  
lëviz duke lypur sytë e mi  
... ..  
dashuri.

... ..

## MBROJTËSIT E ULQINIT

### *luftëtarëve të Lidhjes së Prizrenit*

Sot gjithçka e dashka dorën tonë  
për t'u bërë prapë e para.

Na thërret deti i tërbuar,  
thërrasin gurët, thërret dheu.  
Si dridhen pemët duke thirrur  
nga frikë e tmerrshme e shterpëzimit.

Nën dorën tonë qetësohen.  
E njohin prekjen, u flet gjaku.  
Në trupin tonë hyjnë nxitimthi  
nëpër dyert e hapura të plagëve.

Ne jemi strehë e tokës sonë,  
përditë me vete e bartim trollin.  
Ai nuk na lë të vdesim,  
ndaj vdekjen tutje e varrosim.

## MJESHTRI PLAK I URAVE

Ecën ngadalë mbi urën që ka ndërtuar vetë.

Nëpër rrudhat e ballit  
sikur i rrjedhin tërë lumenjtë e vjetër e të rinj  
që brigjet ua lidhi me krahë të hekurt.

Gishtërinjtë i janë holluar e forcuar si ganxha,  
shpatullat formën e harqeve të urave i kanë  
marrë;  
nëpër to erozioni i ujërave të viteve thyhet.

Në kokë flokët të bardha, të bardha  
a thua se i ka mbështjellë shkuma e stërkalave.

## PARATHËNËSI I FATIT

— Migjenit —

Ata që e kanë njohur e mbajnë mend  
gjithnjë të veshur me kostumin e pastër,  
këmishën e bardhë dhe kravatën  
dhe s'e panë kurrë të hipte në fron

si orakull  
e prej andej  
të shpallte ndonjë kataklizëm të afërme,  
t'i çudiste e t'i frikësonte injorantët.

Ashtu, veshur me ç'kishte mundur të blinte  
me rrogën e vet të paktë si mësues  
dilte nëpër rrugë  
Ndryshe nga të tjerët,  
s'fuste kurrë dorën në xhep  
për t'u dhënë diçka lypësve  
pasi s'kish nevojë të dukej i mirë  
dhe e dinte,  
një dyshkë e tij asgjë s'do t'u sillte.

Në shtëpi

te motrat e shihnin si hahej me veten  
dhe kur zemërimi shpërtheu, ai tha:

«Mjerimi s'don mëshirë, don vetëm të drejtë.»

Pas kësaj mbajnë mend si u bë më i zyrtë.

Në shtëpi, në rrugë me motrat, me shokët,  
vështrimi i tij kërkonte të ngulej diku,

Duhej gjetur ai që do ta sillte të drejtën.

Derisa erdh një çast që ai tha prapë:

«Na të birtë e shekullit të ri.»

Ata që ishin më të zgjuar, më dinakët  
në qeveri,

me këto fjalë panë tek ai

parathënësin e kobshëm të fatit të tyre.

Dhe për të mos e lënë të vazhdonte më tutje

thirrën në ndihmë sëmundjen

që do t'i sillte vdekjen...



MYZEQE 1978

Duke e njohur peshën e fjalës bukë  
kjo tokë shenjtërohet para teje,  
dhe një kokrrizë dheu, dhe një copë diell  
brenda së gjelbrës së një gjetheje.

Njerëz të njohur të gjithë më parë  
në dyqanin ku shitet buka,  
dhe pse fytyrat s'ua kemi parë  
përditë ua kemi takuar duart.

Tokë e zezë, tokë e butë  
që fle e zgjohesh në sytë e fshatarëve,  
e bëhesh pagjumësia e tyre,  
pagjumësia jonë  
për të peshuar më rëndë  
në dashurinë e madhe.

## BA JRAM CURRI

Njeriu s'është kurrë sa trupi i tij,  
ai ka hapësirën e dashurisë.

Ka njerëz të vegjël, të vegjël,  
që kanë vetëm mish, që kanë vetëm kocka  
e asgjë më shumë për të ngrohur të paktën  
rrobat e veta.

Po ka njerëz si ti  
që tek jeta e tyre gjejnë jetë  
dhe për fushat, për malet e për qiejt e kaltër,  
gjejnë jetë për lirinë.

Ndaj ajo pushkë që të mori ty,  
mori malësinë shtëpi për shtëpi,  
mori Kosovën bri në bri.

Plumbi mbeti nëpër shkëmbinjtë e fortë  
të kësaj toke  
e s'arriti dot kurrë deri tek zemra jote...

STATUJAT ILIRE TË FËMIJËVE  
NË MUZEUN KOMBËTAR

E kishit nënën dhe babanë.  
Nga dashuria e tyre për jetën  
lindët ju.

Me sy të mëdhenj,  
me gjak të ngrohtë,  
do ta shtynit larg vdekjen e prindërve,  
përtej moshës suaj,  
përtej moshës së fëmijëve e nipërve.

Kur vdekja s'u la të rriteshit,  
gazi i tyre u ngri në buzë.

Nga toka në kulmin e qiellit  
prej dhimbjes u ngri dita,  
u bë mermer i bardhë

për t'ju përsëritur ju.

Se ju duhej të rronit patjetër  
për ta përcjellë larg, larg  
gjakun dhe trajtat e fytyrës së prindërve.

E unë, ende pa u bërë baba  
para jush e ndiej dhimbjen e tyre...

## VALLJA E BURRAVE

Një jetë e tërë në një hap.

1911. A. 11697

Në thyerjen e gjurit,  
në mbështetjen e këmbës,  
të fryjë erë, të bjerë borë,  
trupi të ndiejë thyerjen e plumbit të hasmit,  
të ndiejë ashtin si thyhet  
e prapë, të mos rrezohet  
për të mos e lënë shtegun të hapur.

Të ndiejë afshin e diellit tek gjaku  
e, të kuptojë disim me rrënjët thellë në shkëmb.

Tek krahu i një zogu të mbahet,  
tek dufini i lumit, tek lulet  
t'i fshehtë që dot s'ij fshihen  
dritës së flokëve të një vajze.

Një jetë e tërë në një hap.

## ERDHA UNË

Duke të ngrohur kaqovite,  
dielli ka lënë ditë për ditë një pjesë të vetes,  
shirat që të kanë lagur, fladi që të ka tharë,  
pranvera, vjeshta, vera, dimri.

Dhe udhët, udhët e shtruara bukur, e udhët e  
malit,  
dheu i butë e guri i fortë i shkëmbit,  
fushat e gjera me grurin, lulet, barin, pemët,  
lumi i kthjellët me jetën e tij të paqetë,  
e pyjet për t'iu trembur heshtjes  
e fjalës së tepërt.

E pastaj, nëna, babai, vëllai, motrat, shokët,  
lodrat, librat, vallja, ëndrrat,  
lodhja dhe gëzimi i lodhjes për t'u lodhur  
prapë  
e prapë për t'u gëzuar, për t'u gëzuar...

Në tërë këtë bujari të çiltën  
ti more pak nga pak format e trupit, të shpirtit,  
ritmin e hapit dhe dritën e syve.  
Atëherë kur nisi të të rëdojë bukuria  
erdha unë ta ndajmë përgjysmë...

**NË QYTETIN E RI**

Oborri s'është më,  
s'është më shtegu,  
tas rruga që më lidhi së pari me botën.  
S'është më arra e madhe,  
vetëm rrënjët e saj do të kenë mbetur diku  
thellë në dhe.

S'është më kopshti,  
as zogjtë e tij, as drurët e pemëve, as lulet,  
as vija e ujit... s'janë më.



Zërin e nënës duke rendur pas meje,  
trupin tim në fluturim,  
mbështetjen tek ajo për të mos rënë  
në hapat e parë e më vonë,  
vetë ata hapa s'kam ku t'i kërkoj

...

Fëmijëria ime-Rozafë në themelet e qytetit të ri.  
Rozafë?

Jo!  
Ajo s'ka lënë për mua jashtë asnjërën dorë,  
asnjërin gji.

asnjërin sy.

## DHENTË NË BJESHKË

Dhentë kthehen nga kullota,  
Në leshrat e tyre të bardha  
ruajnë dritën e ditës të mos ikë me diellin.

Të përjetshme këtu  
si shkëmbinjtë, pishat e bora,  
zgjerojnë hapësirën e këtyre majëmaleve  
duke sjellë njeriun...

## NXËNËSITË E MI LUAJNË LUFTASH

Liria ka edhe fytyrën e nxënësve të mi.  
Ajri është ajër për mushkëritë e tyre  
pa tymra të hidhura, pa zjarrminë e flakëve,  
në librat e reja pa njolla gjaku  
mësojnë të vërtetën e vetëm të vërtetën.

Zgjohen në mëngjes nga prekja e ngrohtë e  
diellit

dhe në klasë  
vetëm zilja ua thyen pak rrjedhën e butë të orëve,  
në bankat prej druri nuk iu gërvishen duart  
nga cifla bombash  
e unë, mësuesi i tyre, në gjuhën e nënës u flas.

Por, mbi grykëset e pastra,  
ata ruajnë gjithmonë të veshur një uniformë  
të padukshme luftëtarësh.

Nga emrat e tyre të rinj, si nga pëndrrat e bukura dalin emrat e njohur të heronjve.

Në pushimet e shkurtra sikur dalin jashtë harrojnë bukën me gjalpë në cantë dhe topin. Nëpër qoshet e shkollës luajnë luftash ndërsa në sytë e ndonjërit loti ende i patharë nga qortimi i mësuesit lëkundet si re e bardhë.

Në inskenimet e tyre të thjeshta është lufta serioze me krisma, me robër e dhimbje plqësh.

Janë gjyshërit e stërgjyshërit me jetën djegur betejave që ringjallen në shumëzimin e rruazave të gjakut e s'mund t'i lënë të harrojnë.

## MARGARITA E KRISTAQ TUTULANI

Ata i nxorrën jashtë qytetit, larg,  
në një mesnatë të errët,

Pa njerëz as zogj përreth.

Donin t'i jepnin vdekjes  
pushtetin e vet të plotë,

S'do të kishin si t'ia linin jetës  
dritën e vështrimit të fundit,  
për fjalët e tyre të fundit  
s'mund të gjendej varr më i mirë  
se honi i zi i natës.

Kujtonin se qielli ish i verbër,  
toka e shurdhër,  
pemët e bari nuk kishin sy as veshë.

Kjo do ta bënte vdekjen e tyre  
vërtet të tmerrshme,  
si vdekje.

Atë mesnatë të errët,  
para skuadrës së pushkatimit  
asnjë amanet s'kish motra për vëllanë,  
asnjë amanet vëllai për motrën.  
Tani s'do të ndaheshin asnjë çast më  
nga njëri-tjetri... as nga ne.

## NË QYTEZËN E SHARRËXHINJVE

Po ngriset. Muzgu s'e nxin dot dëborën.  
Sharrëxhinjtë zbresin nga mali.

Aty ku duken shtëpitë, vështrimi i tyre çel  
portat.  
Në vatra i shtohen dru zjarrit. Gratë dalin te  
pragu.

Deri te pragu, pse të shkojnë më larg!  
Në fytyrat e tyre të skuqura pakëz  
ndihet si shpejtojnë burrat hapat. Është ftohtë,  
ato kanë hedhur diçka të lehtë supeve,  
s'do të shkojnë larg, ja, deri te pragu.  
Aty duart e tyre të vrara nga puna,  
duke iu shkundur dëborën,  
peshojnë një çast mbi supet e burrave,  
një çast, sa për t'ua tretur lodhjen.

Në heshtjen dhe fjalët e tyre të përmbajtura  
s'ka asgjë prej llafomanisë së grave koketa  
që tërë ditën flasin për jetën e burrave të vet,  
përpiqen të bindin veten se ata kanë shumë vlera

dhe se ato i duan vërtet sa s'jetojnë dot pa ta  
e, nga mëngjesi në mbrëmje  
formulojnë me veten dialogë me fjalë të bukura,  
prekëse,

inskenojnë tablo idilike

në krevatin e butë bashkëshortor,  
para pasqyrash të mëdha kërkojnë të gjejnë  
ngjyrat e fustanit që shkon më tepër me të kuqin  
e buzëve  
e rimelin e syve.

Dhe ndodh që në mbrëmje, vonë,  
qajnë me ngashërim

e ankohen për ftohtësinë e burrave.

E pra, në një çast të vetëm

sa s'arrijnë ta kapin as fëmijët,

ato duar që peshojnë mbi supet e sharrëxhinjve,

u thonë atyre se kush është gruaja

dhe ata hyjnë brenda të ngrohin edhe më  
shtëpinë

me frymën e tyre...



PRISHITINE

PARA MONUMENTIT TË 5 HERONJVE TË VIGUT

Ky qytet nga mijëra e mijëra të vdekurit e tij  
ju rilindi ju.

Dihet, nënat tuaja s'mund t'ju bënin  
dhe një herë.

Ju ratë për qytetin dhe qyteti jua kishte peng  
jetën.

Ju rilindi me gurët dhe baltën e vet,  
me ato që ka dhe që ndërton shtëpitë dhe rrugët  
për t'iu bërë strehë e ngrohtë jetës.

## PRISHTINË

Çdo tokë ka pak vend për varret  
për të mos e lënë vdekjen mes të gjallëve.

Ty deshën të të bënë të tërën varr.

Të hodhën rreth qafës tela me gjemba,  
të zunë gojën me emrin e tmerrshëm KAMP  
që të mos merrje dot frymë,  
që të mos nxirrje dot fjalë.

Për të mos e parë qiellin që të kujtonte lirinë  
të ngulën në sy brinjët e thyera të kryqit.

Kujtuan se t'i morën gojën dhe sytë  
e nisën me trupin tënd të mësojnë  
anatominë.  
U duhej të gjenin si të vdesë zemra  
po gjaku dhe muskujt të kishin jetë.

Trupi yt i mësuar të ngrohë veç farën e grurit,  
rrënjët e pemëve,  
të ngrohë këmbët e z bathura të njerëzve të vet  
s'kish ku ta gjente atë ftohtësirë të tmerrshme  
për të ngrirë dashurinë e jetës.

Ajo dashuri mblodhi ngrohtësinë tënde  
mijëravjeçare,  
ua dha bijve të ndiznin zjarret..

## NGA KËNGA E RRUGËS

.....

Kam në pëllëmbë ngrohtësinë e shumë duarve,  
dritën e shumë syve në fytyrë.  
Kështu me mijëra njerëz që kam bërë miq  
mbi rrugën tonë të gjerë shtrojnë dashuri.

Nën të zë vend mirë toka.  
Aty çelin pemët dhe në pikë të dimrit,  
çahet shkëmbi i bardhë të gufojnë ujërat,  
sa herë mbështes këmbën, bëhem më i lehtë.

Bëhem më i lehtë e iki më tutje,  
tutje, s'ndalet hapi, bëj miq të rinj,  
të tjera duar marr në pëllëmbë,  
dritë të re sysh në fytyrë.

Jo nën llampa, nën kokrrat e pjekura të pemëve  
rruga zgjatet para, para pa mbarim.

.....

.....

## KTHIMI NË SHTËPINË E PRINDËRVE

Për të mbërritur atje rruga është e gjatë.

Më shumë se gjithçka

udhëtimin ma shkurton përfytyrimi:

Pas këtij mali më mbetet vetëm një mal,

Pas (kësaj) luginë veç një luginë.

Aty ku mund ta shoh me sy shtëpinë

përfytyrimi mbyllet,

aty ku shoh si çelet dera,

Është nëna te pragu,

dëgjoj edhe zërat e njërezve brenda;

e kuptoj se babanë e shtrirë në minder

zakon i sjelljes së atit me birin

mezi e mban në vend,

aty, gjymtyrët e mi të palodhur nga rruga

se si mpihen, se si hutohen.

SHKURTIMI I "KËMBËN TË DREJTUAR"

Në hapin e parë  
në hapin e dytë

ajri më mblidhet te sytë,  
në hapin e tretë,

bëhem fëmijë,  
tretet mpirja, hutimi,  
gjymtyrët lëshohen në rendje të lirë,

Këtu gjithçka është imja e unë jam i tyre.  
Për t'i përqafuar njëherësh  
të vegjël, sa të vegjël, i kam krahët...

## DITA E FESTËS

Kjo ditë ka fytyrën e gëzimit të njerëzve. dielli i saj i vërtetë janë sytë e tyre të qeshur që gjithçkaje i japin jetë, gjithçkaje i japin dritë duke e bërë të brohorasë për lumturinë e tyre.

Në këtë ditë, kur njerëzit janë më të nxituar se kurrë, edhe një përshëndetje më shumë, edhe një duartrokitje më shumë për ta shprehur gëzimin deri në fund.

DITA E FESTËS

E megjithatë gjejnë kohë më shumë  
edhe për krehjen e flokëve,  
edhe për të veshur më bukur fëmijët;  
çka lë mangut shqetësimi i punës ditëve të tjera.  
sot patjetër duhet të jetë e plotë.

Sepse njerëzit e dinë:  
festë e vërtetë janë ditët e tjera  
kur prodhohen buka, fishekzjarret, flamurët për  
këtu,  
dhe e sotmja nuk është veçse refren i tyre  
ku shpërthen krenar zëri i ndershëm i punës.



## KËNGA E ÇIKAVE

Ka gjëra në jetën e tyre  
që s'ua shpreh dot fjala.

Një bisedë e dëshiruar...  
Një bisedë e belbëzuar, e thyer,  
e vërtitur më kot rreth një fjale të vetme  
si rreth një rrotullame të pakapshme ere...

E në mes këtyre dy bisedave  
shumë e shumë gjëra të tjera...  
Fjala, pakëz nga druajtja,  
pakëz nga pafuqia  
s'ua shpreh e s'ua shpreh...

Por, ato ndjenja, ato mendime  
s'kanë lindur për të vdekur te vetja.

Atëherë  
u vjen në ndihmë e gjithëpushtetshmja—

kënga.

## KËNGA E ÇIKAVË

Ka gjëra në jetën e tyre  
që s'ua shpreh dot lirisht.

Një pjesë e dashur...

Një pjesë e helbësuar e fryer.

SELVIA  
si rreth një orizullimi të pakashtime erë.

Udhëtar i rastit kaloj pranë teje  
dhe mendoj për vetminë tënde të tmerrshme.  
Plakesh vetmevete dimër e verë  
pa e njohur gëzimin e jetës në pyll.

Gëzimin t'i bësh ballë zemërimit të erës  
a të thyhesh për të mos u përkulur para saj.  
Gëzimin e rrënjëve që kapen pas shkëmbinjve  
për të mos u gremisur në humnerë.

Ekzotikë shterpe. Ti ke frikë nga toka

ALJO ISHTE E BUKUR

e zgjatesh drejt qiejve. Ti ke frikë nga vjeshta  
e s'nxjerr asnjë gjethe. Ti ke frikë nga vetja  
e kotesh në heshtje. Ti ke frikë nga jeta.

Të paktën përkëdheljen e një bishti ketri,  
prekjen e krahëve të një blete të merrje me vete  
që kur të digjet ndonjë ditë trupi yt i tharë  
të ketë kujt t'i vijë keq për ç'ka lënë aty.

## AJO ISHTE E BUKUR

Ajo ishte e bukur, vërtet ishte e bukur,  
(tani s'e pranoj dot bukurinë e saj!)  
Flisnim në klasë për dashurinë

siç flasin shokët,

rriteshin fjalët

prej të qeshurës së saj të kristaltë.

Ajo ishte e bukur, vërtet ishte e bukur.

(Tani s'është më e bukur vërtet.)

Ç'duhet e qeshura

e mbledhur në dy gropëzat e faqeve  
kur s'di kujt i qesh?

Krejt rastësisht m'u kujtua sot kur e pashë  
të kridhej në det, mbështetur në krahët e atij,  
m'u kujtua edhe shoku im i dikurshëm,

fytyra e tij e trishtuar se humbi dashurinë.

S'kish ç'i thoshte ai, s'kish ç'i thoshim ne,  
shoqes sonë i duhej një burrë ku të mbështetej.  
Dhe iu shua e qeshura që i buronte prej  
dashurisë,  
siç shuhen ngjyrat e ditës në një muzg të dimërt.

Ishte e bukur,  
tani s'është më e bukur vërtet.  
A mund të krenohet njeriu me sytë?  
A mund të të bëjnë të bukur  
lëkura e bardhë, flokët?  
...Në krahun e tij le të qeshë për të e për vete.

## VJERSHA E NJË SHKOLLARI PËR PARTINË

Me bindjen e njeriut që e di përse lufton  
shpesh ndiej si digjet mesnata në sytë e mi  
mbi libra.

E ti që i jep dritë qëllimit tim  
ma fshin lodhjen me kujdesin që ka për birin  
nëna.

Ti je mësimi im i parë dhe të gjitha mësimet e  
tjera

për ta njohur të vërtetën e jetës  
e për t'u kapur fort pas saj,  
me qartësinë e mendimit tënd  
i shoh gjërat ashtu siç janë.

Ti je mësimi im i parë  
dhe të gjitha mësimet e tjera.

## NË VLORË

I njihja të gjitha më parë:

Tokën që merr frymë nëpër gjethet e ullinjve,  
baltën e saj  
me gjakun e ngrohtë të Selam Musait.

Detin që te toka nis e mbaron te toka  
e toka ia ruan ngjyrën e kaltër,  
qytetin me të gjallët e pavdekshëm  
e të vdekurit e gjallë,

Mbrëmjen që rikrijon flokët e tu  
dhe sytë e tu, dhe trupin tënd  
e ti, në mirënjohje  
i jep zërin...

E unë eci këtu si në një vend të njohur,  
pa u hutuar, pa humbur rrugë.  
Të gjitha i kam gjetur më parë,  
e dashur, në trajtat e tua.

**KËTA NUK VDESIN ...**

*(Tre malësorëve nga Bytyçi i Tropojës të varur në Gjakovë në pranverën e vitit 1944 nga nazistët gjermanë.)*

I torturuan çnjerëzisht:  
u futën kripë në të çarat e thonjve,  
ua nxorën damarët jashtë.

Atëherë dikush tha:

Këta nuk vdesin se i kanë këmbët në tokë.

Dhe i varën.

Këmbët e tyre u zgjatën,

u zgjatën drejt tokës,

kur s'mundën ta prekin,

u ftohën...



## TROKET PRANVERA

Rak-tak-tak po troket dera,  
dil moj gocë, se erdh' pranvera.

Trokasin ujërat e blerta të lumit,  
troket ajri i larë si sy,  
trokas unë.

Trokasin lulet e bardha të pemëve,  
troket avulli i ngrohtë i tokës,  
trokas unë.

Trokasin retë mbi krahë zogjsh,

troket shiu si padurimi im,  
trokas unë.

Trokas unë  
e s'e di ku trokas, tek ti a tek vetja.

Ku mbaron ti e filloj unë?

Troket pranvera.  
Pranvera s'troket,  
pranvera i shqyen dyer, dritare  
për të hyrë jeta.

GRATË E MINATORËVE

Gjithë ditën në fushë.  
Mendimi se diku thellë, thellë  
janë burrat  
ua bën tokën edhe më të dashur.

E ngutën të mbjellin më shumë  
grurë, pemë,  
t'u dërgojnë nëpër rrënjët e tyre diellin.

Në mbrëmje pyesin:  
Si e mbajnë malin e fushën mbi supe  
kur vetëm kokat e tyre të bukura  
mbështetur mbi ta  
i bëjnë të drithërohen?

## E SHTUNA E DASMËS

...E loti mbushi syrin e saj,  
sonte s'është as nuse, sonte s'është as vajzë.

Syri i saj u mbush...s'është lot,  
syri i saj u mbush me diellin e bardhë,

Sonte s'është as nuse, sonte s'është as vajzë.

Syri i saj u mbush me hënë e plotë,  
diell e hënë bashkë këtë natë.

Për të parë larg... larg, në fëmijëri,  
për të parë të fshehtën e krahavorit të burrit...

Sonte s'është më vajzë, ende s'është bërë nuse.

## MALLI

Dielli e ndien mungesën e zogjve,  
mungesën e bimëve në dimër  
e është aq i zbehtë  
si të mos ishte diell.

Po malli vetëm njeriun mërr  
e i mëson atij  
të fshehtën e shkurtimit të largësive.

Pa këtë mall  
diçka do të m'i mungonte ditës e jetës;  
do të m'i mungonte nxitimi  
për të ardhur te ti.

Sic do t'i mungonte tokës  
nxitimi për të thirrur zogjtë e bimët  
për të dalë nga dimri.

## Ç'MUND TË THEM UNË PARA JUSH?

— në vend të një reportazhi për veteranët —  
1.

Doli prapë gjethi i ri.  
Kur sot, në mëngjes herët,  
patë në oborr  
se pema ishte veshur sërish me të gjelbra  
lëshuat ofshamën lehtësuese:

— Erdhi pranvera!

Kështu vit për vit.  
Që nga koha e Operacionit të Dimrit  
gjithnjë e gjithnjë, me padurim  
prisni ardhjen e gjelbërimit, të ri.

Kështu që nga koha e Operacionit të Dimrit,  
në fytyrat tuaja,  
në gjymtyrët e ngrëna prej udhës së gjatë  
është ringjallur natyra.

Kur na lindët ne  
 ende kishit copëra predhash në trup,  
 siç kishte Atdheu mina  
 në bregdet dhe në kryqëzimin e rrugëve —  
 sapo kish mbaruar lufta.

Duhej bërë gjithçka për t'u mbyllur plagët  
 dhe pse mungonin mjekët,  
 dhe pse mungonin spitalet,  
 prapëseprapë duheshin mbyllur plagët.

Duheshin mbyllur shpejt,  
 ish urdhri suprem i luftës së re.

Atëherë, trupi që s'mund ta mbante  
 në vete metalin e huaj,  
 e shkriu pak nga pak,  
 e treti në eshtra e në gjak.

Ashtu s'kish si të mos e përcillnit te ne!  
 Ish fati ynë i madh  
 që ju kishim baballarë.

Ç'të them unë para jush?

S'kam parë kurrë shok të vrarë,  
shok të përpëlitet me plumbin në ballë,  
të përpëlitet, të përpëlitet  
e të mos lëshojë një rënkim, një klithmë,  
të mos thotë një fjalë.

Se shokët sulmojnë,

nuk duhet që shokët të të dëgjojnë

së e ndalin hapin,

e heqin syrin e pushkës nga hasmi.

Shokët sulmojnë,

për një çast

dhimbja jote do t'i bëjë të ndalen

kur lufta e kërkon njëqind fish zjarrin.

Ndryshe si mund të bëhet jeta

të mos e ndërpresë dot vdekja?!

Ç'të them unë para jush?

4.

Gjithnjë mbrëmjeve e keni një çast të vështirë.  
Tek na shihni të kthehemi të përqaftuar  
ne, nipërit tuaj —

djem e vajza të bukura —  
në një çast, në një çast të vetëm  
një dhimbje ju mblidhet te sytë.



Në atë çast të shkurtër ju ringjallet lufta  
jo më në therjen e plagëve të mbyllura,  
as në lagështirën reumatike  
që ju ka hyrë në eshtra;  
ata që u vranë, djem e vajza,  
ishin shokë lufte — ishin shumë —  
ishin dhe gëzimi i ardhmë i dasmave tuaja.

Natyrisht, ju u martuat  
dhe bëtë fëmijë si vetja,  
po dashuria e parë, e vrrarë prej pushtuesit  
mbeti plagë  
si të gjitha plagët që të lë plumbi.

Dhimbja e saj që ju mblidhet te sytë  
njëzëzish ua krijon atë çast të vështirë,  
ju bën ta kuptoni  
dashurinë tonë të mirë.

Ne e ndiejmë, e shohim  
dhe nën marshin triumfal të të dashuruarve  
para jush kalojmë me nderim.

5.

Qyteti është i madh e i vogël  
për hapat tuaj të menduar.  
Takoheni te rruga «Kozma Nushi»,  
pini një kafe në rrugën «Margarita Tutulani»,  
shëtisni në rrugën «Skënder Çaçi».

Dita është e shkurtër  
për t'i shkelur të tëra rrugët  
me hapat tuaj të menduar.

Por prapë, prapë  
dhe shokët e rënë duhen takuar.  
Si ju, si ata,  
banorë të dashur të këtij qyteti,  
si ju, si ata,  
keni lindur gjetkë  
e ndoshta këtu as keni luftuar.

Si ju, si ata, kur mbaroi lufta  
nuk thatë:

— Për ne, kaq!

Të ktheheshit te vatra që ju kishte lindur,  
te bagëtitë dhe toka që shpërndau Reforma  
dhe pse i donit shumë,  
dhe pse jetën pa to  
s'e kishit menduar kurrë.

Tani kishit mësuar fjalën e re «shërbim»  
dhe ashtu siç ishit, të gjallë e të rënë  
u nisët për ku ju thërrisnin.

6.

8 Nëntori e nisi jetën me ju  
duke ju mësuar së pari se keni të ardhme.

E ardhmja ish afër, ish edhe larg.

Për ju do të thosh, do të thoshi:

## Përgjithmonë

u ngritët mbi brezat e mëparshëm.

U ngritët...

E ardhmja s'ish thjesht  
të shtohet një copë bukë në tryezë  
të mos vdesin fëmijët urie,  
një fustan më i mirë për gruan  
ta mbajë më ngrohtë,  
ta bëjë më të bukur;  
e ardhmja s'ish kaq.

Të dalë njeriu prej ëndrrës së tij  
si zogu prej lëvozhgës së vezës —  
të mos hyjë më dot aty,

të krijojë një ëndërr të re  
për të rilindur prapë prej saj  
edhe më i lartë, edhe më i bukur,  
të gremisë perënditë nga tempujt e lashtë,  
nga fronet mbretërore;  
njeriu mbi botën e vet të pasur,  
të bëhet perëndi!

Ju mësoi 8 Nëntori.

E ju nisët të flisni për të  
pakëz me drojtje, pakëz me pasiguri.  
Veç kur e ndiet si dihaste

duke rendur para jush

thatë:

— Ja ku është!

S'e latë më t'u humbiste nga sytë.

Që atëherë,  
në gjithfarë përfytyrimesh të bukura  
e ardhmja s'ju doli kurrë  
ndryshe nga si e kenë arritur.

E prapë, për ditë  
ajo rend e rend para jush,  
aq joshëse në bukurinë e saj  
sa s'ju lë kohë të ndaleni

për t'u plakur

E ardhmja!

## P È R M B A J T J A

	Faqe
Jeta e udhëve .....	3
Tri këngë për nënën .....	5
Tani .....	8
Heronjtë .....	9
Donika .....	10
Vajzat kthehen nga fusha .....	12
Vetëm unë do mbes e bardhë .....	13
Skenë njerëzore .....	14
Në qytetin e fëmijërisë .....	15
Bjeshkët në dimër .....	16
Për vajzat .....	17
Në ekspozitën e piktorëve të vegjël .....	18
Minatorët malësorë .....	20
Shoku .....	21
Shëtitje natën në pyll .....	22
Dëshirë për të thënë diçka për Onufrin .....	23
Vdekja e gjyshit .....	24
Intime .....	27
Sepse e dua botën .....	28
Vajtim për Emin Durakun .....	30
Ja, koka ime e mbështetur te ti... ..	32
E diela e njerëzve të punës .....	33
Pionierët dëshmorë .....	34
Drita e syrit .....	35
Mbrojtësit e Ulqinit .....	37
Mjeshtri plak i urave .....	38

Parathënësi i fatit .....	39
Myzeqe 1978 .....	41
Bajram Curri .....	42
Statujat ilire të fëmijëve në Muzeun Kombëtar	43
Vallja e burrave .....	45
Erdha unë .....	46
Në qytetin e ri .....	48
Dhentë në bjeshkë .....	50
Nxënësit e mi luajnë luftash .....	51
Margarita e Kristaq Tutulani .....	53
Në qytezën e sharrëxhinjve .....	55
Para Monumentit të 5 Heronjve të Vigut .....	57
Prishtinë .....	58
Nga kënga e rrugës .....	60
Kthimi në shtëpinë e prindërve .....	61
Dita e festës .....	63
Kënga e çikave .....	65
Selvia .....	66
Ajo ishte e bukur .....	68
Vjersha e një shkollari për Partinë .....	70
Në Vlorë .....	71
Këta nuk vdesin .....	72
Troket pranvera .....	73
Gratë e minatorëve .....	75
E shtuna e dasmës .....	76
Malli .....	77
Ç'mund të them unë para jush .....	78

Mustafaj, B.

Pragu i verës. [Red.: I. Thoma].

T., «Naim Frashëri», 1985.

88 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-1

M 98

Tirazhi 1500 kopje    Format 49x78/16    Stash 2204-79

Shtypur KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e  
Re — Tiranë, 1985